



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1276 / 4 Prot.

Tiranë, më 20.05.2026

VENDIM

Nr. 27, datë 20. 05.2026

“PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E PËRBASHKËTA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE TË CIKLIT TË TRETË “MASTER EKZEKUTIV”, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, neni 6, pika 30, neni 47 dhe neni 49; në Statutin e UMT-së neni 5 dhe neni 51; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018, i ndryshuar; në propozimin e Fakultetit të Mjekësisë Dentare me shkresën nr. 1061/4 prot., datë 30.04.2026, si dhe në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 56, datë 11.05.2026 “Për tarifat e shkollimit për programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2026-2027, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit të UMT-së.

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2026-2027, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Studentët e regjistruar në programet e përbashkëta të studimit, të cilët nuk përfundojnë programin përkatës të studimit apo nuk shlyejnë të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, brenda kohëzgjatjes normale të tij, do të trajtohen sipas përcaktimeve në marrëveshjet specifike dhe rregulloret përkatëse të programeve të sipërcituara, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA ÇINOPULLI

ALTINA XHAFFERI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ

Tabela nr.1: Tarifatat e shkollimit për programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2026-2027

Nr.	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i Studimit	Tarifë vjetore
1	F. i Mjekësisë Dentare	II	Master Profesional/Master Ndërkombëtar i Nivelit të Parë në “Higjenë Dentare dhe Terapi Parodontale jo Kirurgjikale”	4000 EU
2	F. i Mjekësisë Dentare	III	Master Ekzekutiv/Master Ndërkombëtar i Nivelit të Dytë në “Implanto Protetikë”	6000 EU